



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 02 / 1781 / Dt. 10 / 11 /2020

Këshilli Drejtues i Universitetit Publik "Kadi Zeka" në Gjilan, në mbledhjen e XX të mbajtur më 05.11.2020, mori vendim të shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për nivlejn baçelor dhe master për vitin akademik 2019/2020

- I. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët e nivelit baçelor dhe master të cilët i plotësojnë këto kushte:
 1. Të jenë studentë të rregulltë;
 2. Të jenë studentë të vitit të dytë dhe më lartë;
 3. Të mos kenë vit të përsëritur;
 4. Të kenë të kryera të gjitha provimet e vitit paraprak në afatin e shtatorit.

Studentët duhet plotësuar edhe kriteret shtesë të aprovura në mbledhjen e XX të Këshillit Drejtues të UKZ-së, të datës 05.11.2020 dhe ato janë:

- Studentët e Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik si dhe programet master: E-Qeverisja dhe Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike duhet të kenë notën mestare së paku 8.50.
 - Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe të Fakultetit të Shkencave Aplikative duhet të kenë notën mesatare së paku 8.00 .
- II. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika I e konkursit duhet të paraqesin këto dokumente:
 - Fletëparaqitjen e plotësuar (shkarkohet nga web faqja e universitetit);
 - Vërtetimin për statusin e studentit (lëshohet nga fakulteti);
 - Pasqyren e provimeve (lëshohet nga fakulteti).
 - III. **Afatet e konkursit:**
 - Aplikimi për bursë universitare bëhet nga data **11.11.2020** deri më datë **19.11.2020**;
 - Dorëzimi i dokumenteve bëhet në fakultetet përkatëse.

Vendimi mbi ndarjen e bursave do të shpallet në web faqen zyrtare të universitetit:

www.uni-gjilan.net

